



**VENDIM**

*Nr. 1, Datë 19.01.2017*

**MBI  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE  
MIRATIMIN E “RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE MARRËVESHJES SË  
PJESËMARRJES NË BURSËN E ORGANIZUAR TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 19 gërma “a” dhe 98 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; si dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të energjisë elektrike” dhe “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike”,

**Konstatohet se :**

- Në bazë të nenit 98 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”: “ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e tregut të energjisë elektrike.
- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016 është vendosur “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”;
- Shoqëria OST sh.a me shkresën e saj nr. 7565, Prot., datë 12.12.2016, paraqiti në ERE për miratim draftin e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike” dhe draftin e “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike.”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e :
  - a) “Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”
    - Specifikimi i Produkteve – Shtojca I
    - Rregullat e Tregut Shqiptar të Ditës në Avancë – Shtojca II
    - Rregullat e Tregut Brenda Ditës – Shtojca III
    - Rregullat e Administrimit të Tregut – Shtojca IV
    - Rregullat për Pagesat dhe Faturimin– Shtojca V
    - Zona e Import/Eksportit – Shtojca VI
    - Termat e Përgjithshme VII,
  - b) “Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në bursën e organizuar të energjisë elektrike.”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a, KESH sh.a., OST sh.a, MEI, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e tjera të interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE**  
**Petrit AHMETI**